

Titulli i lëndës: PROJEKTIM 5 – KOMPLEKSET INDUSTRIALE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arkitekturës
Titulli i lëndës:	PROJEKTIM 5 – KOMPLEKSET INDUSTRIALE
Niveli:	baçelor
Statusi i lëndës:	obligative
Viti i studimeve:	Viti III / semestri VI
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.asoc.dr. Arta Xhambazi
Të dhënat kontaktuese:	arta.xhambazi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kursi Projektim 5 – Komplekset Industriale trajton projektimin arkitektonik të objekteve dhe komplekseve industriale në lidhje me proceset teknologjike të prodhimit, organizimin hapësinor të funksioneve dhe sistemet e logjistikës dhe transportit, duke marrë parasysh kontekstin urban dhe territorial. Lënda fokusohet në analizën e tipologjive të arkitekturës industriale, kriteret për përzgjedhjen e lokacionit dhe organizimin e hapësirave të prodhimit, magazinimit dhe qarkullimit.</p> <p>Procesi i projektimit zhvillohet përmes analizës së precedentëve arkitektonikë dhe studimit të një industrie ekzistuese në kontekstin lokal, mbi bazën e të cilave studentët zhvillojnë programin projektues dhe kërkesat funksionale të kompleksit industrial. Kjo qasje mbështetet në një pedagogji të bazuar në hulumtim, ku analiza dhe interpretimi i rasteve reale shërbejnë si bazë për zhvillimin e konceptit arkitektonik. Vëmendje e veçantë i kushtohet marrëdhënies ndërmjet procesit teknologjik, organizimit hapësinor dhe sistemit strukturor, si elemente themelore të formësimit arkitektonik të ndërtesave industriale.</p> <p>Kursi organizohet përmes ligjëratave dhe ushtrimeve projektuese, ku ligjëratat mbështesin procesin e projektimit duke trajtuar parimet tipologjike, teknologjike dhe konstruktive të arkitekturës industriale, ndërsa ushtrimet fokusohen në zhvillimin e një projekti arkitektonik për një kompleks industrial në një lokacion të caktuar.</p>
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> – zhvillimi i aftësisë për analizën e tipologjive dhe organizimit funksional të komplekseve industriale – zhvillimi i kompetencës për formulimin e programit projektues mbi bazën e analizës së proceseve prodhuese – fuqizimi i aftësisë për zhvillimin e një koncepti arkitektonik për komplekse industriale në raport me procesin teknologjik dhe strukturën ndërtimore

	<ul style="list-style-type: none"> – fuqizimi i kompetencës për komunikimin grafik dhe argumentimin e projektit arkitektonik
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kursit studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – RN1 – Analizojë tipologjitë e ndërtesave dhe komplekseve industriale. – RN2 – Interpretojë marrëdhënien ndërmjet procesit teknologjik, organizimit hapësinor dhe sistemit strukturor të ndërtesës industriale. – RN3 – Vlerësojë kriteret për përzgjedhjen dhe organizimin e lokacionit industrial. – RN4 – Zhvillojë programin projektues mbi bazën e analizës së një industrie ekzistuese. – RN5 – Zhvillojë një koncept arkitektonik për një kompleks industrial. – RN6 – Paraqesë projektin përmes vizatimeve arkitektonike dhe prezantimeve grafike.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Ushtrime / Studio	2	15	30
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	0.3	5	1.5
Puna në terren	4	3	12
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin testin/ final	2	7	14
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.	0.5	3	1.5
Total			150

Metodat e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> – Ligjërata tematike mbi parimet e arkitekturës industriale dhe organizimin e proceseve teknologjike që mbështesin procesin e projektimit (RN1, RN2) – Analiza tipologjike dhe studimi i precedentëve të arkitekturës industriale (RN1, RN3) – Analiza e një industrie ekzistuese dhe identifikimi i kërkesave funksionale të procesit prodhues (RN2, RN4) – Zhvillimi i programit projektues dhe formulimi i konceptit arkitektonik gjatë ushtrimeve (RN4, RN5) – Ushtrime projektuese të mbikëqyrura dhe konsultime gjatë zhvillimit të projektit (RN5, RN6) – Prezantime dhe diskutime kritike të projektit gjatë procesit të projektimit (RN5, RN6)
--------------------------------	--

Metodat e vlerësimit:	<p>Projekti semestral – 70% Zhvillimi i një projekti arkitektonik për një kompleks industrial mbi bazën e analizës së një industrie ekzistuese. (Vlerëson: RN2, RN4, RN5, RN6)</p> <p><i>Kriteret:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> – organizimi funksional i kompleksit industrial – integrimi i procesit teknologjik në organizimin hapësinor – koherenca ndërmjet sistemit strukturor dhe organizimit hapësinor – qartësia dhe koherenca e konceptit arkitektonik – qartësia dhe cilësia e prezantimit grafik <p>Provimi me shkrim – 30% Verifikimi i njohurive teorike mbi tipologjitë dhe parimet e projektimit të arkitekturës industriale.(Vlerëson: RN1, RN3)</p> <p><i>Kriteret:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> – njohja e tipologjive industriale – kuptimi i parimeve të organizimit funksional – interpretimi i marrëdhënieve ndërmjet – eknologjisë, strukturës dhe arkitekturës – përdorimi korrekt i terminologjisë profesionale
------------------------------	---

Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Weyer, J., & Baragaño, S. (2014). <i>Industrial Building Planning and Design</i>. Design Media Publishing. 2. Adam, J., Hausmann, K., & Jüttner, F. (2004). <i>Industrial Buildings: Design Manuals</i>. Birkhäuser. 3. Markovics, J. (2023). <i>Industrial Architecture</i>. Cherry Lake Publishing.
Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Neufert, E., & Neufert, P. (2012). <i>Architects' Data</i>. Wiley-Blackwell. 2. Kamen, R. (1981). <i>Factories: Planning and Design</i>.

Hartimi i planit mësimor		
Java	Titulli i ligjëratës	Ushtrime / Studio
Java 1: 16.02	Industria bashkëkohore dhe roli i arkitekturës industriale	Analizë industrie + proces + program paraprak
Java 2: 23.02	Evolucioni i arkitekturës industriale dhe tipologjitë	Analizë tipologjike industrie
Java 3: 2.03	Lokacioni industrial dhe konteksti urban-territorial	Analizë lokacioni + qasje
Java 4: 9.03	Organizimi funksional dhe procesi teknologjik	Program funksional paraprak
Java 5: 16.03	Sistemet e qarkullimit dhe logjistika	Program + zonim

	industriale	
Java 6: 23.03	Strukturat dhe hapësirat e mëdha industriale	Situacion + koncept vëllimor
Java 7: 30.03.	Funksionet përcjellëse dhe infrastruktura industriale	Situacion final + volum
Java 8: 06.04.	pushim	Plan + volum (zëvendësim)
Java 9: 13.04.	pushim	Plan zhvillim (zëvendësim)
Java 10: 20.04	Kollokfium I (test)	Plan + prerje fillestare
Java 11: 7.04	Fleksibiliteti dhe modulariteti në arkitekturën industriale	Prerje + strukturë
Java 12: 04.05	Qëndrueshmëria dhe industria e gjelbër	Prerje + volum final + Arkitekturë fillestare
Java 13: 11.05	pushim	Arkitekturë zhvillim ((zëvendësim)
Java 14: 18.05.	Industria dhe transformimi: reuse dhe industri urbane + Kollokfium II	Arkitekturë zhvillim
Java 15: 25.05.	Sinteza e projektimit industrial bashkëkohor	Prezantimi i final

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Të gjithë anëtarët e kursit pritet të sillen me profesionalizëm dhe respekt të ndërsjellë, pa asnjë formë diskriminimi apo ngacmimi. Pajisjet digjitale lejohen vetëm për qëllime akademike, ndërsa plagjiatura, kopjimi dhe çdo formë mosndershmërie akademike nuk lejohen — të gjitha burimet duhet të citohen sipas standardit [APA/MLA] dhe çdo përdorim i AI duhet deklaruar; dorëzimi i materialeve të gjeneruara plotësisht nga AI pa kontribut personal konsiderohet shkelje akademike.

Detyrat dorëzohen brenda afatit të caktuar.

Të drejtë vijimi kanë vetëm studentët që kanë përfunduar pjesën e detyrave praktike për lëndët **Projektim 3 dhe Projektim 4.**

Marrja e kredive kushtëzohet me vijim të rregullt në ligjërata dhe ushtrime (prania është e detyrueshme dhe më shumë se 3 mungesa nuk lejohen), me zhvillimin e plotë dhe vlerësimin pozitiv të detyrave semestrale, si dhe me kalimin e verifikimit teorik (kollokfiumi ose provimi).

Mosplotësimi i prerekuiziteve mund të rezultojë në çregjistrim nga lënda.